AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Gusht 2023

22.09.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin gusht 2023.

Rritet deficiti tregtar në gusht 2023 për 3,1%, krahasuar me gusht 2022

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 3,1% në muajin gusht 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 455,8 milion Euro, krahasuar me deficitin 441,9 milion Euro në vitin 2022. Eksporti mbulon importin me 12,9%.

Eksporti i mallrave në muajin gusht 2023 kishte vlerën 67,3 milion Euro, ndërsa importi 523,1 milion Euro, që është një rënie prej (-20,7%) për eksport, si dhe (-0.7%) për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 21,7% e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 19,1% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13,7% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12,3% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 5,4% e përbëjnë produktet bimore, etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 16,9% e përbëjnë produktet minerale; 12,6% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,8% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 10,3% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9,4% e përbëjnë mjetet e transportit; 6,0% e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 5,9% e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij, etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	Gusht 2022		Gusht 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**84 891**	**100,0**	**67 342**	**100,0**
27 vendet e BE-së	31 000	36,5	20 643	30,7
Cefta	32 281	38,0	26 769	39,8
Të tjera	21 610	25,5	19 930	29,6
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**526 829**	**100,0**	**523 154**	**100,0**
27 vendet e BE-së	213 239	40,5	217 053	41,5
Cefta	100 020	19,0	73 224	14,0
Të tjera	213 570	40,5	232 877	44,5

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 20,6 milion Euro, ose rreth 30,7% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-33,4%). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (12,3%), Italia (3,3%), Holanda (3,2%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 217,0 milion Euro, ose 41,5% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 1,8%. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (11,8%), Greqia (6,0%), Italia (4,4%), etj.

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 26,7 milion Euro, ose 39,8% të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-17,1%). Partnerë kryesorë për eksport ishin: Shqipëria (14,3%), Maqedonia e Veriut (13,4%), Mali i Zi (5,4%), Serbia (5,2%).

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 73,2 milion Euro, ose 14,0% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-26,8%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (5,5%), Maqedonia e Veriut (4,5%), Serbia (2,1%).

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 19,9 milion Euro, ose 29,6%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: SHBA (15,9%) dhe Zvicra (8,5%).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 232,8 milion Euro, ose 44,5%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (13,0%) dhe Kina (12,7%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin gusht 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade